



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 31.01.2014

Nr. 0204-137

PËR: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Halim Halimi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË PRISHTINËS Nr.031-17324, pranuar me datën 29.01.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.031-17324 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës me datën 22.01.2014, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2008 për Pagesën e Stafit Politik në Komuna.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi Nr. 031-17324 për Pagesën e Stafit Politikë të Komunës së Prishtinës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum, 31.01.2014
br. 0204-137

Za: Shpend Ahmeti, Gradonačelnik opštine Priština
Halim Halimi, Predsedavajući Skupštine opštine Priština

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Priština
br. 031-17324, primljeno dana 29.01.2014

Poštovani ,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi , kao i uredbe br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva ,dodatak XII, nakon razmatranja odluke br.031-17324 odobreno od strane Skupštine opštine Priština dana 22.01.2014, Potvrđuje zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi i administrativnim uputstvom br. 16/2008 o platama političkog osoblja u opštini.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi :

- Odluka br.031-17324 o platama političkog osoblja u opštini Priština.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 14 të Udhëzimit administrativ nr. 16/2008, për pagesën e stafit politik në komuna dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 22.1.2014, merr këtë

V E N D I M
P Ë R
P A G E S Ë N E S T A F I T P O L I T I K T Ë K O M U N Ë S

I.

MIRATOHET Vendimi për caktimin e pagës dhe kompensimit të stafit politik të Komunës së Prishtinës.

II.

Sipas pikës I të këtij vendimi, pagesa është si në vijim:

1. Paga mujore bruto e Kryetarit të Komunës, 1210, 00 €;
2. Paga mujore bruto e nënkryetarit të Komunës, 726.50 €;
3. Paga mujore bruto e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, 605, 00 €;
4. Kompensimi mujor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, 100, 00 €;
5. Kompensimi shtesë i anëtarëve të Kuvendit të Komunës: për çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës 125,00 € dhe pjesëmarrja në komitetet e përhershme për çdo takim pune 50,00 €;
6. Paga mujore bruto e drejtorëve të drejtorive, 525,00 €.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe e Pronës.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 01- 031- 17324, më 22.1.2014

